

KARTA E APOSTOLLIT PAVEL MBE GALLATIANETE

Krye 1

¹ Pavli, apostoll (jo prej njerëzish, as me anë njeriu, po me anë të Jisu Krishtit, edhe të Perëndisë Atit që e ngjalli atë prej së-vdekurish.) ² Edhe gjithë vëllezëritë **që janë** bashkë me mua, mbë kishërat të Gallatisë; ³ Hir **qoftë** mbë ju edhe paqtim nga Perëndia Ati, edhe nga Zoti ynë Jisu Krisht, ⁴ Që dha vetëhen' e ti për fajetë t'anë, që të na shpëtonjë nga këjo jet' e-ligë, pas dashurimit të Perëndisë edhe Atit t'ënë, ⁵ Mbë të-cilinë **qoftë** lavdia ndë jetët të jetëvet. Amin.

⁶ Çuditëm se kaqë çpejt shkoni prej ati që u thirri juve me anë të hirit të Krishtit ndë tjetërë ungjill; ⁷ I-cili nuk' është tjetërë, po janë ca **veta**, të-cilëtë u trumbullonjënë juve, edhe duanë të ndryshonjënë ungjillin' e Krishtit. ⁸ Po edhe neve, a ëngjell prej qielli ndë u lëçittë juve **tjatër'** ungjill e jo atë që u lëçitmë juve, qoft' i-mallëkuarë. ⁹ Sikundrë thamë më përpara, edhe ndashti përsëri them, Ndë u lëçittë juve ndonjë **njeri tjetër'** ungjill e jo atë që kini marrë, qoft' i-mallëkuarë. ¹⁰ Sepse ndashti njerësvet u mbush mëndjenë unë apo Perëndisë? apo kërkonj të pëlqehem te njerëzitë? sepse ndë pëlqeheshe edhe te njerëzitë, nukë dotë ishnjam shërbëtuar i Krishtit.

¹¹ Po u bënë të dini ju, o vëllezër, se ungjilli që ulëçit prej meje s'është pas njeriu; ¹² Sepse as unë s'e mora prej njeriu, as umësuashë **prej njeriu**, po prej sbulesë së Jisu Krishtit. ¹³ Sepse kini dëgjuarë, se qysh shkonjam njëherë ndë Judhaismët, se fort tepërë ndiqnjam kishën' e Perëndisë, edhe e bënjam rrënullë; ¹⁴ Edhe vinjam mbarë ndë Judhaismët më tepërë se shumë moshëtarë **të mi** ndë kompt t'im, sepse ishnjam më tepërë zilitar për porositë që kishinë lënë atërit' e mi.

¹⁵ Po kur i pëlqeu Perëndisë që më ndau **veç** që nga barku i mëmësë, edhe më thirri me anë të hirit të ti, ¹⁶ Që të sbulonjë Birin' e ti tek unë, që t'a ungjillëzonj atë ndër kombet, për-një-here s'mora këshillë nga mish a nga gjak; ¹⁷ As nukë hipa ndë Jerusolim te apostojtë që qenë përpara meje, po vajta nd'Aravi, edhe përsëri ukthyeshtë ndë Dhamaskë. ¹⁸ Pastaj pas tre vjeç hipa ndë Jerusolim, për të pjekurë me Pjetrinë; edhe mbeta për'an' ati pesë-mbë-dhjetë dit; ¹⁹ Edhe tjetërë nga apostojtë nukë pashë, veç Jakovinë të vë-llan' e Zotit. ²⁰ Edhe sa u shkruanj juve, ja **tek po rrëfenj** përpara Perëndisë, se s'gënjenj. ²¹ Pastaj erdha ndë vëndet të Syrisë edhe të Qiliqisë; ²² Edhe nukë ishnjam njohurë me faqe me kishët' e Judhesë që ishinë mbë Krishtinë; ²³ Po vetëmë kishinë dëgjuarë, se ay që na ndiqte njëherë, ndashti po ungjillëzon **atë** besënë që bënte rrënullë njëherë. ²⁴ Edhe lavduroninë Perëndinë për punë t'ime.

Krye 2

¹ Pastaj pas katër-mbë-dhjetë vjeç përsëri hipa ndë Jerusolim bashkë me Varnavënë, si mora me vetëhe edhe Titonë; ² Edhe hipa pas sbulesë **nga an' e Perëndisë**, edhe u rrëfeva atyre ungjillinë që lëçis ndër kombet, po më tepërë atyreve që dukeshinë më të-shënuarë, **nga frika** semos breth, a brodha mbë kot. ³ Po as Titua që që bashkë me mua, ndonëse ishte Grek, nuk' ushtrëngua të rrethpritetë; ⁴ Edhe **këjo** për vëllezërit' e-rrem që ishinë futurë fshehuraj, të-cilëtë hynë fshehuraj, për të përgjuarë lirinë t'ënë që kemi mbë Jisu Krishtinë, që të na bënë robër; ⁵ Këtyreve as për një orë nuk' u unjmë kryetë që t'u bindemi, që të mbesë te ju e-vërtet' e ungjillit. ⁶ Edhe për ata që u duketë se diç janë,

çfarëdo që të kenë qënë ndonjëherë, asfare s'dua të di; Perëndia nukë shikon mbë faqe njeriu; sepse ata që dukenë **se diç janë** nukë shtuanë gjë tek unë; ⁷ Po përkundrazi, kur panë se mua m'ubesua ungjilli i parrethpresjesë, sikundrë Pjetrit **ungjilli** i rrethpresjesë; ⁸ (Sepse ay që vepëroj mbë Pjetrinë që të jetë apostoll mbë të-rrethprerëtë, vepëroj edhe mbë mua **që të jem apostoll** mbë kombetë;)⁹ Edhe si e njohnë hirinë që m'udha, Jakovi e Qifaj e Joani, të-cilëtë dukeshinë se ishinë shtylla, **na** dhanë mua edhe Varnavësë të-djathtat' **e tyre** për **shënjë** shoqërie, që neve **të vemi** ndër kombet, e ata ndë të-rrethprerët; ¹⁰ Vetëmë **na porositnë** të kujtojmë të-vobeqtë; të-cilënë punë edhe ukujdesa t'a bënj.

¹¹ Edhe kur erdhi Pjetri ndë Antiohi, i ndënjta kundrë për faqe, sepse vëjente të qërtonej; ¹² Sepse pa ardhurë ca **veta** nga Jakovi, hante bashkë me kombetë; po kur erthnë, hiqej edhe e ndante **veç** vetëhen' e ti, sepse kishte frikë nga ata që ishinë prej rrethpresjesë. ¹³ Edhe bashkë me atë uhoqnë **veç** edhe të-tjerëtë Judhenj, kaqë sa edhe Varnava uhoq ndë ipokrisit t'atyreve. ¹⁴ Po kur pashë, se nuk' ecënjënë drejt sipas së-vërtetës' s'ungjillit, i thashë Pjetrit përpara të gjithëve, Ndë qoftë se ti që je Judhe rron posi kombetë, e jo posi Judhenjtë, përse shtrëngon kombetë të rronjënë posi Judhenjtë? ¹⁵ Neve që jemi prej fisi Judhenj edhe jo prej kombesh fajtores, ¹⁶ Dyke diturë, se s'del i-drejtë njeriu prej punërash nomi, veç me anë të besës' së Jisu Krishtit, edhe neve i besuamë Jisu Krishtit, që të dalëmë të-drejtë prej besës' së Krishtit, e jo prej punëravet të nomit; sepse asndonjë njeri s'ka për të dalë i-drejtë prej punëravet të nomit. ¹⁷ Po ndë qoftë se, dyke kërkuarë të dalëmë të-drejtë mbë Krishtinë, ugjëntmë edhe neve fajtorë, Krishti pa fjalë qënka shërbëtuar i fajit? Qoftë lark.

¹⁸ Sepse ndë ndërtonj përsëri ato që prisha, bënj vetëhenë t'ime porosi-prishës. ¹⁹ Sepse unë me anë të nomit vdiqa ndë nomt, që të rronj mbë Perëndinë. ²⁰ Bashkë me Krishtinë ukryqëzuashë; Edhe s'rronj më unë, po Krishti rron tek unë; edhe ajo që rronj **unë** ndashti ndë misht, rronj ndë besët të Birit të Perëndisë, i-cili më deshë edhe dha ndër duar vetëhen' e ti për mua. ²¹ Nukë heth poshtë hirin' e Perëndisë; sepse ndë qoftë të-drejtëruarëtë me anë të nomit, atëhere Krishti vdiq mbë kot.

Krye 3

¹ O Gallatiannë të-marrë, kush u mëreu juve, (që të mos bindeni mbë të-vërtetënë,) përpara syvet të të-cilëvet Jisu Krishti upërshkrua i-kryqëzuarë ndër mest t'uaj. ² Këtë vetëmë dua të marr vesh prej jush, Prej punërash nomi e muartë Frymënë, apo prej të-dëgjuarit të besësë? ³ Kaqë të-marrë qënki? passi nistë me Frymë, ndashti mbaroni me mish. ⁴ Mbë kot pësuatë kaqë? ndë qoftë se vetëmë mbë kot. ⁵ Ay pra që u ep juve Frymënë, edhe punon çudira ndër ju, prej punërash nomi **i bën këto**, a prej të-dëgjuarit të besësë?

⁶ Sikundrë "Avraami i besoj Perëndisë, edhe i unumërua ati për drejtëri;" ⁷ Di-e-ni pra, se ata që janë prej besësë, këta janë bij t'Avraamit. ⁸ Edhe shkronja dyke parë që përpara se Perëndia nxjer kombetë të-drejtë prej besësë, i dha zë Avraamit që përpara, "Se gjithë kombetë dotë bekonenë mbë ty." ⁹ Përandaj ata **që janë** prej besësë bekonenë bashkë me besëtarinë Avraam.

¹⁰ Sepse sa **njerës** janë prej punërash nomi janë ndënë mallëkim; sepse është shkruarë, "I-mallëkuarë është cilido që s'qëndron mbë gjithato që janë shkruarë ndë vllit të nomit, për të bër' ato." ¹¹ Po se asndonjë s'del i-drejtë me anë të nomit përpara Perëndisë, është **gjë** e-çfaqurë "Sepse i-drejtë dotë rronjë prej besësë." ¹² Edhe nomi nuk' është prej besësë, po "njeriu që bën ato, dotë rronjë me anë t'atyreve." ¹³ Krishti na çpërbleu nga mallëkimi i nomit, sepse ubë mallëkim për ne; sepse është shkruarë "I-mallëkuarë është sicilido që varretë ndë dru." ¹⁴ Që të vinjë

bekimi i Avraamit ndër kombet me anë të lisu Krishtit, që të marrëmë të-zotuarët' e Frymësë me anë të besësë.

¹⁵O vëllezër, si njeri flas; po **edhe** dhjatë njeriu, passi vërtetonetë, asnjeri s'e heth poshtë, a shton **gjë mb'atë**. ¹⁶Edhe të-zotuarat' i ufolnë Avraamit edhe farës' s'ati; nukë thotë, Edhe faravet, si për shumë, po si për një "Edhe farësë s'ate," që është Krishti. ¹⁷Edhe këtë e them, se dhjatënë që qe vërtetuarë më përpara prej Perëndisë mbë Krishtinë nomi që ubë pas katrë qint e tri-dhjetë vjeç nuk' e heth poshtë, që të prishnjë të-zotuarëtë. ¹⁸Sepse ndë qoftë se trashëgimi është prej nomi, nuk' është më prej të-zotuari; po Perëndia j'a fali këtë Avraamit me anë të të-zotuarit.

¹⁹Përse pra **udha** nomi? Ushtua për punë të të-shkeluravet të porosivet, gjersa të-vinte fara, mbë të-cilënë qe bërë të-zotuarëtë; edhe **ky nom** uurdhërua me anë të ëngjëjve ndë dorët të **një** mestari. ²⁰Edhe mestari s'është i njëj **vetëmë**; po Perëndia është një.

²¹Nomi pra **qënka** kundrë të-zotuaravet të Perëndisë? Qoftë lark! sepse ndë ishte dhënë nom që munt të apë jetë, **atëhere** drejtëria dot' ishte me të-vërtetë prej nomi; ²²Po shkronja i mbylli të-gjitha ndënë fajinë, që t'u epetë të-zotuarëtë prej besësë mbë Jisu Krishtinë atyreve që besonjënë. ²³Edhe përpara se të vinte besa, ruheshimë ndënë nom, të-mbyllurë brënda ndë besët, e-cila ishte për të sbuluarë. ²⁴Përandaj nomi ubë mësonjësi ynë mbë Krishtinë, që të dalëmë të-drejtë prej besësë; ²⁵Po passi erdhi besa, s'jemi më ndënë mësonjës.

²⁶Sepse të-gjithë jemi të Perëndisë me anë të besësë që është mbë Jisu Krishtinë. ²⁷Sepse sa jeni pagëzuarë mbë Krishtinë, Krishtinë kini veshurë. ²⁸Nukë ka **më** Judhe as Grek; nukë ka **më** shërbëtuar as të-lirë; nukë ka **më** mashkull e femërë; sepse ju të-gjithë jeni mbë Jisu Krishtinë. ²⁹Edhe ndë jini ju të Krishtit, pa fjalë, jini far' e Avraamit, edhe pas të-zotuarit trashëgimtarë.

Krye 4

¹Edhe them, **se** sa kohë trashëgimtarë është foshnjë, s'ndan nga shërbëtori, ndonëse është i zot' i të-gjithave; ²Po është ndënë qivernitarë e kujdestarë, gjer mb'atë kohë që është urdhëruarë nga i ati. ³Kështu edhe neve, kur ishimë foshnjë, ishimë robër ndënë stihiat të botësë; ⁴Po kur erdhi të-mbushurit' e kohësë, Perëndia dërgoj të Birinë, që lindi prej gruaje edhe që qe ndënë nom, ⁵Që të çpërblenjë ata që ishinë ndënë nom, që të marrënë birërinë. ⁶Edhe me-qënë-që jemi bij, Perëndia dërgoj Frymën' e Birit të ti ndë zëmërat t'uaj që thërret, Avva, o Atë. ⁷Përandaj nukë je më shërbëtuar, po bir; edhe ndë je bir, **je** edhe trashëgimtar i Perëndisë me anë të Krishtit.

⁸Po atëhere, passi s'njihnitë Perëndinë u punuatë atyreve që s'janë prej nature perëndira; ⁹Po ndashti, passi njohtë Perëndinë, **e që të them** më mirë unjohtë prej Perëndisë, qysh ktheti përsëri mbë të-dobëtat' e mbë të-vobegatë stihia, të-cilavet prapë si përpara doni t'u punoni? ¹⁰Vini re dit, e muaj, e kohëra, e vjet. ¹¹Kam frikë për ju semos mbë kot umunduashë për ju.

¹²O vëllezër, u lutem juve bëhi posi unë, sepse edhe unë jam posi ju; s'më keni bërë ndonjë të-keqe. ¹³Edhe e dini, se të-parënë herë u'a lëçita juve ungjillinë më dobësirë të mishit. ¹⁴Edhe ngasjenë t'ime që kishnjam ndë mishit t'im nuk' e zutë për gjë, as e hothtë tej, po më prittë si ëngjëll Perëndie, si Jisu Krishtinë. ¹⁵Cila pra ishte lumëria juaj? Sepse dëshmonj për ju, se ndë mundej, **edhe** sytë t'uaj dot' i nxirnitë e dotë m'i epnitë mua. ¹⁶Armiku juaj pra ubëshë, se u them juve të-vërtetënë?

¹⁷Dëftenjënë zëmërë të-përvëluarë të ju, po jo të-mirë; përkundrazi duanë t'u mbyllinjënë juve jashtë, që të keni **juve** zëmërë të-përvëluarë për ata. ¹⁸Po **është**

mirë të keni zëmëre të-përvëluarë për të-mirënë gjithënjë, e jo vetëmë kur gjëndem ndë mest t'uaj. ¹⁹ Djemthit' e mi, përsëri kam të-dhëmbura të-pjelli për ju, gjersa të formonetë Krishti ndër ju; ²⁰ Edhe donjam të ishnjam ndë mest t'uaj ndashti, edhe të ndërronjam zënë t'im, sepse nukë di ç'të mendonem për ju.

²¹ Pa më thoni, ju që doni të jeni ndënë nom, a nukë dëgjoni nomnë? ²² Sepse është shkruarë, se Avraami pat dy bij; një prej shërbëtoresë, edhe një prej së-lirësë; ²³ Po ay që lindi prej shërbëtoresë lindi pas mishit; e ay **që lindi** prej së-lirësë, lindi me anë të të-zotuarit. ²⁴ Të-cilatë dëftënjë për tjetërë; sepse këtu janë të dy dhjatatë; njëra nga mali Sina, që pjell për skllavëri, e-cila është Agara. ²⁵ (Sepse Agara është mali Sina nd'Arabi, edhe përgjigjetë ndë Jerusalem të-sotmë; edhe është ndë skllavëri bashkë me të bjitë.) ²⁶ Po Jerusalem **që është** lart është e lirë, e-cila është mëma e neve të-gjithëve. ²⁷ Sepse është shkruarë, "Gëzohu **tí**, o shterpë që nukë pjell; nxir zënë edhe thërrit ti që nukë ke të-dhëmbura të-pjelli' sepse djemt' e shkretëtirësë **janë** më shumë se t'asaj që ka burrinë;" ²⁸ Edhe neve, o vëllezër, jemi, posi Isaaku, bij të të-zotuarit. ²⁹ Po sikundrë atëhere ay që lindi pas mishit ndiqte atë **që kishte lindurë** pas frymësë, kështu **është** edhe ndashti. ³⁰ Po ç'thotë shkronja? "Nxir jashtë shërbëtoren' edhe të birrin' e asaj; sepse s'ka për të trashëguarë i bir' i shërbëtoresë bashkë me të birin' e së-lirësë."

³¹ Nukë jemi pra, o vëllezër, bij të shërbëtoresë, po të së-lirësë.

Krye 5

¹ Qëndroni pra ndë lirit, me të-cilënë na liroj Krishti, edhe mos hyni përsëri ndë sgjedhët të skllavërisë.

² Ja unë Pavli te që u them juve, se, ndë urrethpërfshi, Krishti nukë dot' u bënë juve dobi asfare. ³ Edhe dëshmonj përsëri mbë çdo njeri që rrethprietë, se është detuar të mbanjë gjithë nominë. ⁴ Undatë nga Krishti ju që delni të-drejtë me anë të nomit; ratë poshtë nga hiri. ⁵ Sepse neve me anë të Frymësë presmë **për** shpresën' e të-drejtëruarit prej besësë. ⁶ Sepse mbë Jisu Krishtinë as rrethpresja ka ndonjë fuqi, as parrethpresja, po besa që vepëronetë me anë dashurie.

⁷ Ju ecënitë mirë; kush u pengoj që të mos bindeni mbë të-vërtetënë? ⁸ Këta të-bindurë nuk' është prej ati që u thërret juve. ⁹ Pakëzë brumë mbruh gjithë të-mbrujturitë. ¹⁰ Unë kam shpresë mbë ju me anë të Zotit, se nukë dotë kini ndër mëntt tjetërë gjë; po ay që u trumbullon juve, cilido që të jetë, ay ka për të mbajturë mundimnë. ¹¹ Edhe unë, o vëllezër, ndë qoftë se lëçis edhe më rrethpresje, përse ndiqem më? atëhere uprish skandhalia e kryqit. ¹² Zoti dhëntë të copëtonenë ata që u trumbullonjë juve.

¹³ Sepse ju, o vëllezër, uthërritë ndë liri; vetëmë mos e përdorni lirinë për shkak të mishit, po me anë të dashurisë t'i shërbeni njëri tjetërit. ¹⁴ Sepse gjithë nomi mbushtë ndë një fjalë, ndë këtë, "Të duash të-afërminë t'ënt si vetëhenë t'ënde." ¹⁵ Po ndë kafshofshi e ndë hëngrëshi njëri tjetërinë, shikoni mos prisheni njëri prej tjetërit.

¹⁶ Them pra, Ecëni pas Frymësë, edhe nukë dotë bëni dëshirimn' e mishit.

¹⁷ Sepse mishi dëshëron kundrë Frymësë, e Fryma kundrë mishit; edhe këto janë njëra kundrë tjetërësë, që të mos bëni ato që doni. ¹⁸ Po ndë qoftë se Fryma u heq udhënë juve, nukë jeni ndënë nom.

¹⁹ Edhe punërat' e mishit janë të-çfaqura; të-cilatë janë pëgërësi, kurvëri, ndyrësi, plank-prishësi, ²⁰ Idhullatri, magji, armiçësira, grindje, zili, zëmërieme, të-zëna, të-ndara, erez, ²¹ Cmire, vrasje, të-dejtura, lodrëti, edhe kësosh si këto; për të-cilatë u them juve më përpara, sikundrë edhe u thashë më përpara, se ata që punonjë të-tillatë mbretëri Perëndie s'kanë për të trashëguarë.

²² Po pem' e frymësë është dashuri, gëzim, paqtim, zëmër' e-gjerë, ëmblësirë, mirësi, besë, ²³ Butësiirë, vetëpërbajtje; kundër të-tillavet nukë ka nom.

²⁴ Edhe ata që janë të Krishtit, e kanë kryqësuarë mishinë bashkë me pësimet' e me dëshërimetë. ²⁵ Ndë rrojmë pas Frymësë, pas Frymësë edhe ecëjmë.

²⁶ Letë mos kërkujmë lavdi të-kotë, dyke ngarë njëri tjetërinë, dyke pasurë cmir njëri tjetërinë.

Krye 6

¹ O vëllezër, edhe ndë rëntë njëri ndë ndonjë faj, ju që jeni të frymësë ndërto-e-ni të-tillinë me frymë butësiirë; dyke vënë re vetëhenë t'ënde, semos ngitesh edhe ti. ² Mbani barrëtë njëri tjetërit, edhe kështu mbushni nomn' e Krishtit. ³ Sepse ndë i duketë ndonjë se diç është, tek s'është gjë, gënjen vetëhen' e ti. ⁴ Po gjithë-sicili letë provonjë punën' e ti, edhe atëhere vetëmë për vetëhen' e ti dotë ketë të-mburruritë, e jo për tjetërinë; ⁵ Sepse gjithë-sicili dotë mbanjë barrën' e ti.

⁶ Edhe ay që mësonetë ndë fjalët **prej ndonjëj**, atë që **e** mëson let'a bënë pjesëtar ndë gjithë të-mirat **të tia**. ⁷ Mos gënjeji; Perëndia nukë përbuzetë; sepse ç'të mbjellë njeriu, këtë edhe dotë korrnjë; ⁸ Sepse ay që mbjell ndë misht të ti, prej mishit dotë korrnjë prishje; po ay që mbjell ndë Frymët, prej Frymësë dotë korrnjë jetë të-përjetëshme. ⁹ Letë mos lodhemi pra dyke bërë të-mirënë, sepse ndë mos ulothçimë, dotë kormë ndë kohët që duhetë. ¹⁰ Përandaj gjersa kemi kohë, letë punojmë të-mirënë mbë të-gjithë, po më fort mb'ata që janë ndë një besë me ne.

¹¹ Shikoni me ç'farë shkronja të-mëdha u shkrova me dorënë t'ime. ¹² Sa duanë të dukenë të-mirë ndë misht, këta u ngutnjënë juve të rrethpriteni, vetëmë që të mos ndiqenë për kryqin' e Krishtit. ¹³ Sepse as ata që rrethpritenë s'e ruanjënë nominë, po duanë të rrethpriteni ju, që të mburrenë ndë misht t'uaj. ¹⁴ Po për mua qoftë lark të mburrem **për tjetëre gjë**, veç për kryqin' e Zotit t'ënë Jisu Krisht, me anë të të-cilit bota është kryqëzuarë tek unë, edhe unë te bota. ¹⁵ Sepse mbë Jisu Krishtinë as rrethpresja ka fuqi, as parrethpresja, po kriesa e-re. ¹⁶ Edhe sa ecënjënë pas kësaj rregulle, **qoftë** paqtim edhe përdëllim mb'ata, edhe mbë Israilin' e Perëndisë.

¹⁷ **Ndashi e** paskëtaj asndonjë letë mos më mundonjë; sepse unë mbanj shënjat' e Zotit Jisu ndë trupt t'im.

¹⁸ Hiri i Zotit t'ënë Jisu Krisht qoftë bashkë me frymënë t'uaj, o vëllezër. Amin